



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:109375
Datë: 14.06.2024
Numri i dokumentit: 05825921

AA.nr.665/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale, Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ të paditësit, N.S, nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson, Ali Latifi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, me seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson, D.H, si dhe pala e interesit, Kompania Rajonale e Ujësjetësimit “Prishtina”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson, S.K, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, nën shenjë A.nr.1244/2021, të datës;27.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.06.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e palës së paditur, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1244/2021, i datës; 27.07.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1244/2021, të datës; 27.07.2023, është vendosur, “*I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.S, kundër të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit. II. ANULOHET vendimi i të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit nr.058/21 datë 26.04.2021. III. Detyrohet e paditura Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit si autoritet përgjegjës, të siguroj që ofruesi i shërbimit Kompania Rajonale e Ujësjetësimit “Prishtina”, të evidentoj gjendjen reale të borxhit, të rregulloj faturimin për pagesë për borxhin e parashkruar për shumën prej 525.64 (pesëqind e njëzë e pesë euro dhe gjashtëdhjetë e katër cent). IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale. V. Ky aktgjykim zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm.”*

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë pala e paditur, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta anuloj aktgjykimin A.nr.1244/2021, të datës;27.07.2023, dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe

rivendosje, ose Gjykata e Apelit të vendos në mënyrë meritore, dhe ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, dhe ta vërtetoj vendimin nr.058/21, të datës;26.04.2021, të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, me seli në Prishtinë.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar pala paditëse, me të cilën i ka propozuar Gjykatës që ankesën e të paditurit ta refuzon, dhe ta vërteton aktgjykimin e kontestuar si të drejtë dhe të ligjshëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e palës së paditur është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i paditurit, me vendimin nr.058/21, të datës 26.04.2021, ka refuzuar ankesën e ankuesit, N.S, lidhur me kërkesën për shlyerje të borxhit të akumuluar për shërbime të ujësjellësit si të pa bazuar dhe ka lënë në fuqi vendimin e KRU “Prishtina” nr.239561, të datës;19.02.2021.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e të paditurit, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë;03.06.2021, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që të lirohet nga borxhi i ngarkuar.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadija e paditësit, me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 43.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar. Gjykata fillimisht kishte parasysh se akti administrativ nuk përmban elementet e aktit administrativ ashtu siç përcakton Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative konkretisht nuk përmban elementet nga neni 47 dhe 48 të këtij Ligji, i njëjti nuk referon provat në të cilat mbështet konstatimet e dhëna, po ashtu referon bazën ligjore duke mos përcaktuar se pse është e aplikueshme në rastin konkret. Nuk përfshihet pretendimi i palës dhe pse nuk është i pranueshëm pretendimi. Gjykata duke pasur parasysh shkresat e lëndës si vendim i dt.26.04.2021, fletë dorëzim i dt.16.03.2021, formulari i Ankesës së konsumatorit për shërbimet e ujit, dt.13.04.2021, vendim i dt.08.02.2021, dëftesë e pagesës dt.06.04.2021, certifikatë nga Njësia Kadastrale 011-953-14155/2016, dt.20.01.2016, vendim i dt.11.01.2018, transaksionet e Konsumatorit 01.01.2016-31.12.2021,01.01.2017-31.12.2021, Kartela e konsumatori 01.01.2013-08.08.2021, 01.01.2013, 31.05.2023, ankesë e dt. 03.06.2021, ankesë 13.04.2021, ankesë 05.01.202, vendim i dt.26.04.2021, procesverbal 12.01.202, shpërndarja e shpenzimit të matësit 2020, kartela e matësit 19.04.2021, 27.07.2023, kontratë e shërbimeve të ujit 08.01.2021, raport mbi ankesën 02.03.2021, aktgjykim A.nr. 165/2020 dt. 12.04.2022, ARJ-41/2022 i dt . 09.06.2022, të dhëna me kontrata nuk identifikohet datë, kopje e fotografisë së ujëmatësit, konstaton se lidhur me borxhin prej 525.64 të referuar nga përfaqësuesi i paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku Gjykata kishte parasysh edhe periudhën kontestuese bazuar në kartelën financiare 01.01.2013-31.05.2023 dhe atë periudhën për 30.11.2016 deri më 31.12.2020 (duke pasur parasysh edhe datë e parashtrimit të ankesës së datës 08.01.2021 pranë KRU-Prishtina lidhur me ngarkimin në fatura), pas së cilës datë konstatohet vlera prej 1.08 euro, andaj konstatohet se borxhi është vjetërsuar (kurse nga shkresat e lëndës konkretisht kartela e matësit 01.01.201-01.12.2023 konstatohet vlera e shpenzuar 0), deri te i cili konstatim erdhi për arsyet si në vijim: Fillimisht gjykata kishte parasysh se nga shikimi në kartelën*

financiare të konsumatorit periudha 01.01.2013-08.01.2021, borxhi rezulton te jete konstatuar ne mënyrë jo te rregullte, pasi qe te pjesa e përshkrimit është konstatuar gjendja fillestare në lartësi prej 472.34 referuar nga periudha 31.12.2013 dhe nuk dihet se ky borxh për cilët muaj dhe vite është faturuar, kurse në rastin konkret detyrimi është periodik, bazuar ne baza mujore. Gjykata kishte parasysh se borxhi për shpenzimet e ujit është borxh periodik me që i njëjti arrin pas përfundimit të çdo muaji dhe me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) neni 360 par 1 Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti, përcakton “1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake;” dhe paragrafit 2 “ Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”, që do të thotë se referuar periudhës kontestuese, parashkrimi llogaritet për secilin muaj në mënyrë të veçantë. Lidhur me faktin e deklarimit të paditësit se kemi parashkrim, gjykata kishte parasysh LMD, ku me nenin 341 përcaktohet:” 2. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”. Me nenin 343 të LMD përcaktohet:” Parashkrimi lind, kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj”. Në NËNKREU 4 NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT Neni 368 të LMD Pranimit i borxhit përcaktohet:”1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. 2. Pranimit i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e kështit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit. Andaj bazuar në pagesat e ujit në kartelën financiare të konsumatorit periudha 01.01.2013-08.01.2021, referuar periudhës kontestuese 30.09.2016, konstatohet se është jo kontestuese se paditësi ka paguar shumën paushallë prej 10.00, 10.00, mirëpo duke mare parasysh se nuk është specifikuar asnjëherë se ajo pagesë me cilin muaj të pagesës së ujit ka të bëjë, nuk mund të thuhet se është ndërprerë parashkrimi i këtij borxhi. Me nenin 369 të LMD përcaktohet: “Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”, kurse me nenin 372 të LMD përcaktohet:” Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin”. Andaj nga arsyet e paraqitura, gjykata duke marrë parasysh se kërkesëpatria për parashkrim ka të bëjë me periudhës 30.09.2016-31.12.2020, (duke pasur parasysh edhe datë e parashkrimit të ankesës së datës 08.01.2021 pranë KRU-Prishtina lidhur me ngarkimin në fatura) sipas shumës për shlyerje borxhi dhe atë 525.64, Gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është i bazuar referuara parashkrimit, me faktin se nga shkresat e lëndës me vendimin e datës 08.02.2021 refuzohet kërkesa lidhur me kontestimin e faturimit për mos shfrytëzim të shërbimeve të ujit si e pabazuar, kurse me vendimin e datës 26.04.2021 refuzohet ankesa e këtu paditësit lidhur me kërkesën për shlyerje të borxhit të akumuluar, ku gjykata këtu kishte parasysh edhe kontratën e datës 08.01.2021. Duke pasur parasysh se parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit, nga shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet kërkesa e përmbushjes së detyrimit, konstatimi si në vendimet e atakuar nuk paraqet bazë për ndërprerje të parashkrimit, për faktin se nuk mjafton që e paditura ta ftoj paditësin në pagesën e borxhit si rrethanë për ndërprerje të parashkrimit në kuptim të nenit 372 të LMD. Gjykata po ashtu kishte parasysh se është lidhur kontrata e datës 08.01.2021, në mes të paditësit dhe palës me interes, lidhur me shërbimet e ujit, por e njëjta nuk i referohet pranimit të detyrimit paraprak, nuk ka efekt retroaktiv dhe po ashtu këtu gjykata kishte parasysh se kjo kontratë prodhon të drejta dhe detyrime për palët nga momenti i lidhjes së saj, lidhur me shërbimet e ujës-jellës dhe ujërave të ndotura. Po ashtu gjykata konstaton se parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë. Andaj bazuar në shkresat e lëndës gjykata ka konstatuar se e paditura me asnjë veprim lidhur me kërkesën e përmbushjes së borxhit nuk e ka ndërprerë parashkrimin, kurse pagesat paushallë nga këtu paditësi lidhur me shpenzimet nuk paraqet bazë për ndërprerjeje të parashkrimit, mare parasysh se kërkesa për furnizim me ujë

është kërkesë e cila parashkruhet pas një (1) viti dhe afati i parashkrimit ka rrjedh nga fundi i vitit në të cilin ka arritur kërkesa për pagesë, që do të thotë se referuar periudhës kontestuese të parashkrimit 30.09.2016-31.12.2020, parashkrimi llogaritet për secilin muaj në mënyrë të veçantë, andaj për të gjitha kërkesat e arritura gjatë vitit 2020, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga 01.01.2021, ku në rastin konkret, e paditura nuk ka dëshmuar me përgjigje në padi apo dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor se ka kërkuar përmbarimin e kërkesave-borxhit, nuk ka dëshmuar se në cilësi të kreditori ka paraqitur propozimit për përmbarim deri në këtë fazë të procedurës së shqyrtimit gjyqësor, me të cilin do të dëshmonte se ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit për kërkesat e arritura gjatë vitit 2019 dhe 2020. Pasiviteti i këtu të paditurës për përmbushjen e kërkesës së tij nga ana e paditësit me kalimin e kohës së parashkuar me ligj, e bën të pamundur përmbushjen e detyrimit përmes rrugës gjyqësore në qoftë se debitori i referohet institutit të parashkrimit. Gjykata kishte parasysh edhe deklarimin e përfaqësuesit të të paditurës dhe palës me interes si në përgjigje në padi dhe në shqyrtim gjyqësor rreth parashkrimit por se Gjykata ka detyrim të merret me pretendimin e paditësit lidhur me parashkrimin dhe se realizimi i kërkesës së parashkuar në procedurë gjyqësore mund të ndodhë vetëm nëse debitori-paditësi në këtë rast nuk i referohet parashkrimit, për shkak se gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare (ex officio) për parashkrimin. Kurse pretendimi se parashkrimi duhet të trajtohet në Gjykatën kompetente në procedurë kontestimore edhe këtë pretendim Gjykata nuk e mori për bazë sepse ekziston praktika gjyqësore e vlerësimit të ekzistimit të parashkrimit(shih aktgjykim A.nr.1738/2016 datë 26.05.2022 dhe Aktgjykim AA.nr. 582/2022 datë;14.03.2023, aktvendim AA.nr.446/19). Andaj parashtrimi i ankesës së këtu paditësit për shlyerje borxhi te e paditura, refuzimi i kërkesës nga e paditura për shlyerje borxhi, parashtrimi i padisë nga këtu paditësi për largimin e borxhit me referim në parashkrim gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk paraqet ndërprerjeje të parashkrimit sepse nuk nënkupton praninë të borxhit me deklaratën e këtu paditësit apo në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit. Kontrata e datës 08.01.2021 nuk paraqet ndërprerje të parashkrimit, e njëjta është kontratë për shërbimin e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, nuk ka efekt retroaktiv, si e tillë nuk përfshinë në asnjë dispozitë të saj ndonjë ri-programim të borxhit, apo deklarin të pranimit të borxhit, e njëjta krijon raport të të drejtave dhe detyrimeve në të cilat janë pajtuar palët sipas dispozitave ligjore . Me nenin 2 paragrafi 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, përcaktohet:” Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Në bazë të nenit 63 të LKA-së, dispozitat e LPK-së do të zbatohen përshtatshmërisht në rastet kur LKA nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, andaj bazuar në këtë, gjykata iu referua nenit 7.1 të LPK-së, ku përcaktohet se: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Ndërsa me nenin 7.3 të këtij ligji, përcaktohet se: “Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarojnë”. Bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të të provuarit, nënkupton një detyrim për palët. Kjo lidhet me detyrimin për respektimin me përpikëri të procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Në këtë kuptim Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës dhe palës me interes dhe konstaton se të njëjtat janë të pa bazuara, sepse me provat e administruara, konstatohet gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga këtu e paditura. Gjykata vendosi si në pikën dy dhe tre të dispozitivit të vendimit duke ju referuar kompetencës së Gjykatës në nenin 9 dhe 43 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe ka vendosur për ligjshmërinë e vendimit përfundimtar administrativ, duke pasur parasysh kompetencën e këtu ta paditurës si autoritet përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të të gjithë ofruesve të shërbimeve dhe duke marrë parasysh se këtu pala me interes Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina”, si organ i shkallës së parë është ofrues i shërbimeve dhe e njëjta sipas statutit të saj është shoqëri

aksionare dhe po ashtu duke pasur parasysh aktgjykim A.nr.1738/2016 datë 26.05.2022 dhe Aktgjykim AA.nr. 582/2022 datë;14.03.2023). Në këtë kuptim Gjykata nuk e shqyrtoi ekzistimin apo mosekzistimin e detyrimit, për faktin se është referuar parashkrimi në këtë procedurë të konfliktit administrativ, për këtë arsye edhe nuk arsyetoi vendimin e saj edhe në referimin e të paditurës në vendimet gjyqësore të administruara si provë sepse të njëjtat i referohen ekzistimit apo mosekzistimit të detyrimit.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit ky pretendim nuk qëndron, ngase i padituri të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë, përkatësisht, në mënyrë specifike se ku qëndrojnë shkeljet të dispozitave të procedurës, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurit në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, duke e anuluar vendimin e të paditurit dhe e ka detyruar të paditurën të evidentoj gjendjen reale të borxhit, të rregulloj faturimin për pagesë për borxhin e parashkruar, për faktin se organi i paditur, në arsyetimin e vendimit kur ka nxjerrë përfundim se “*e paditura me asnjë veprim lidhur me kërkesën e përmbushjes së borxhit nuk e ka ndërprerë parashkrimin, kurse pagesat paushallë nga këtu paditësi lidhur me shpenzimet nuk paraqet bazë për ndërprerjeje të parashkrimit, mare parasysh se kërkesa për furnizim me ujë është kërkesë e cila parashkruhet pas një (1) viti dhe afati i parashkrimit ka rrjedh nga fundi i vitit në të cilin ka arritur kërkesa për pagesë, që do të thotë se referuar periudhës kontestuese të parashkrimit 30.09.2016-31.12.2020, parashkrimi llogaritet për secilin muaj në mënyrë të veçantë, andaj për të gjitha kërkesat e arritura gjatë vitit 2020, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga 01.01.2021, ku në rastin konkret, e paditura nuk ka dëshmuar me përgjigje në padi apo dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor se ka kërkuar përmbarimin e kërkesave-borxhit, nuk ka dëshmuar se në cilësi të kreditori ka paraqitur propozimit për përmbarim deri në këtë fazë të procedurës së shqyrtimit gjyqësor, me të cilin do të dëshmonte se ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit për kërkesat e arritura gjatë vitit 2019 dhe 2020. Pasiviteti i këtu të paditurës për përmbushjen e kërkesës së tij nga ana e paditësit me kalimin e kohës së parashikuar me ligj, e bën të pamundur përmbushjen e detyrimit përmes rrugës gjyqësore në qoftë se debitori i referohet institutit të parashkrimit.”*

Kolegji i apelit si Gjykata e shkallës së parë vlerëson se ky arsyetim i vendimit është i paqartë, dhe në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, dhe mbi këto arsye në ri-procedurë, i padituri duhet të evidentoj gjendjen reale të borxhit, të rregulloj faturimin për pagesë për borxhin e parashkruar, për përkatësisht të veprojnë në bazë të përfundimit të nxjerrë nga Gjykata e shkallës së parë kur ka konstatuar se “*duke marrë parasysh se kërkesëpadija për parashkrim ka të bëjë me periudhës 30.09.2016-31.12.2020, (duke pasur parasysh edhe datë e parashkrimit të ankesës së datës 08.01.2021 pranë KRU-Prishtina lidhur me ngarkimin në fatura) sipas shumës për shlyerje borxhi dhe atë 525.64, Gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është i bazuar referuara parashkrimit, me faktin se nga shkresat e lëndës me vendimin e datës 08.02.2021 refuzohet kërkesa lidhur me kontestimin e faturimit për mos shfrytëzim të shërbimeve të ujit si e pabazuar, kurse me vendimin e datës 26.04.2021 refuzohet ankesa e këtu paditësit lidhur me kërkesën për*

shlyerje të borxhit të akumuluar, ku gjykata këtu kishte parasysh edhe kontratën e datës 08.01.2021. Duke pasur parasysh se parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit, nga shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet kërkesa e përmbushjes së detyrimit, konstatimi si në vendimet e atakuar nuk paraqet bazë për ndërprerje të parashkrimit, për faktin se nuk mjafton që e paditura ta ftoj paditësin në pagesën e borxhit si rrethanë për ndërprerje të parashkrimit në kuptim të nenit 372 të LMD. Gjykata po ashtu kishte parasysh se është lidhur kontrata e datës 08.01.2021, në mes të paditësit dhe palës me interes, lidhur me shërbimet e ujit, por e njëjta nuk i referohet pranimit të detyrimit paraprak, nuk ka efekt retroaktiv dhe po ashtu këtu gjykata kishte parasysh se kjo kontratë prodhon të drejta dhe detyrime për palët nga momenti i lidhjes së saj, lidhur me shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura. Po ashtu gjykata konstaton se parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”.

Sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit edhe ky pretendim nuk qëndron, ngase i padituri të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka specifikuar saktë se ku qëndron vërtetimi gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, e rrjedhimisht nga kjo edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Në këtë kuptim kolegji i apelit vlerëson se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditurit, dhe se thëniet e ankesës kolegji i apelit nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike, e rrjedhimisht edhe drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.665/2023, datë;13.06.2024

Kryetari i kolegjit
Hajriz Hoti